

Dr. Tony B. Watlington Sr., Ed.D.
Superintendent

9 Nëntor 2023

Të Nderuara Familje të Drejtorisë Arsimore të Filadelfias,

Sot, kam kënaqësinë të ndaj disa lajme pozitive në lidhje me rezultatet tona të provimit të PSSA dhe Keystone për 2022-2023. Më 8 Nëntor 2023, [Departamenti i Arsimit i Pensilvanisë](#) (PDE) njoftoi [rezultatet](#) e Sistemit të Vlerësimit të Shkollës së Pensilvanisë (PSSA) dhe Provimet Keystone për vitin shkollor 2022-2023. Drejtoria pa rezultate të përmirësuara të provimeve të studentëve në 13 nga 17 fusha për nxënësit e klasave 3-12, duke përfshirë rritje të aftësisë dhe reduktime në nivelin bazë.

Departamenti i Arsimit i Pensilvanisë (PDE) kërkon që nxënësit e shkollave publike të Pensilvanisë të marrin dy lloje vlerësimesh të standardizuara: [Sistemi i Vlerësimit të Shkollës së Pensilvanisë \(PSSA\)](#) (ose [Sistemi Alternativ i Vlerësimit të Pensilvanisë \(PASA\)](#)) për nxënësit me aftësi të kufizuara në klasat 3-8, dhe [Keystone exams](#) në klasat 8-11, pas përfundimit të lëndëve specifike. Nxënësit e klasës së tretë deri në të tetë të marrin PSSA në “English Language Arts” (ELA) dhe Matematikë. Nxënësit e klasës së katërt dhe të tetë të testohen edhe në Shkenca. Shihni më poshtë për pikat kryesore të PSSA dhe Keystone:

PSSA Math

- Përqindja e nxënësve të klasave 3 deri në 8 që arritën nivelin “Proficient or Advanced” u rrit me 4.2 pikë përqindje nga 16.5% në 2021-2022 në 20.7% në 2022-23.
- Përqindja e nxënësve të klasave 3 deri në 8 që arritën nën nivelin bazë ra me 4,9 pikë përqindje, nga 61,7% në 2021-2022 në 56,8% në 2022-2023.
- Përqindja e nxënësve të klasës së tretë që arritën nivelin “Proficient or Advanced “ u rrit me 5,7 pikë përqindje nga 20,8% në 2021-2022 në 26,5% në 2022-23.
- Përqindja e nxënësve të klasës së tretë që arriten nën nivelin bazë gjithashtu ra me 6.9 pikë përqindje nga 58.9% në 2021-2022 në 52% në 2022-23.

PSSA English Language Arts

- Përqindja e studentëve që arritën nivelin “Proficient or Advanced” nga klasat 3 deri në 8 mbetën të qëndrueshme në rreth 34%.
- Përqindja e nxënësve të klasës 3 deri në 8 që arritën nën nivelin bazë ra me 1.8 pikë përqindje nga 28.2% në 26.4% midis 2021-22 dhe 2022-23.
- Përqindja e nxënësve të klasës së tretë që arritën nivelin “Proficient or Advanced “ u rrit me 2.9 pikë përqindje nga 28.1% në 2021-2022 në 31% në 2022-23.
- Përqindja e nxënësve të klasës së tretë që arritën nën nivelin bazë në PSSA ELA ra me 6.6 pikë përqindjeje, nga 38.2% në 2021-2022 në 31.4% në 2022-23.

PSSA Science

- Përqindja e studentëve që ishin në nivelin “Proficient” në Shkencë u rrit 3.1 pikë përqindje nga 37.1% në 2021-22 në 40.2% në 2022-23.

- Përqindja e nxënësve të klasës 3 deri në 8 që arritën nën nivelin bazë ra me 2 pikë përqindje nga 35.6% në 33.6% midis 2021-22 dhe 2022-23.

Keystone Literature

- Përqindja e nxënësve të klasës së 11-të që arritën nivelin “Proficient or Advanced” në Letërsi u rrit me 6.3 pikë përqindje nga 47.6% në 2018-19 në 53.9% në 2022-2023.

Keystone Biologji

- Përqindja e nxënësve të klasës së 11-të që arritën nën nivelin bazë ra me pothuajse 5.2 pikë përqindje nga 43.2% në 2018-19 në 38% në 2022-2023.

Për më tepër, përqindja e studentëve të kualifikuar të klasës së 12-të të Karrierës dhe Arsimit Teknik (CTE) që rezultuan kompetent ose më lart në një test të Institutit Kombëtar të Testimit të Kompetencës Profesionale (NOCTI) të lidhur me industrinë u rrit nga 43.4% në 2021-22 në 49.1% në 2022-23, një rritje prej 5.7 pikë përqindjeje. PDE kërkon NOCTI si një vlerësim të bazuar në industri për CTE.

Progresi akademik i studentëve tanë përputhet me përmirësimin e vazhdueshëm të qëllimeve tona mbështetëse: siguria, frekuentimi i studentëve, frekuentimi i mësuesve, braktisja dhe shkalla e diplomimit. Konkretisht, ne rritëm numrin e rrugëve të sigurta nga 6 në 2021-2022 në 13 në 2022-23, rritëm frekuentimin e rregullt të studentëve me 3 pikë përqindje nga 57% në 2021-22 në 60% në 2022-23, rritëm frekuentimin e rregullt të mësuesve me 7 pikë përqindje nga 77% në 2021-22 në 84% në 2022-23, dhe u zvogëlua braktisja nga shkolla e studentëve me 265 studentë nga 2021-22 në 2022-23, duke siguruar që 86% e nxënësve të klasës së 12-të të plotësonin kërkesat e reja të diplomimit shtetëror.

Përparimet akademike që po bëjnë fëmijët tuaj janë një pasqyrim i drejtpërdrejtë i përfshirjes suaj të paçmuar. Këto rezultate pozitive janë dëshmi se puna jonë e palodhur kolektive po bën vërtet ndryshim.

Faleminderit që zgjodhët Drejtorinë Arsimore të Filadelfisë për arsimimin e fëmijës suaj. Ne mezi presim të punojmë me ju ndërsa vazhdojmë t'i përgatisim studentët tanë për të imagjinuar dhe realizuar çdo të ardhme që dëshirojnë.

Në Partneritet,



Tony B. Watlington Sr., Ed.D.

Superintendenti

Drejtoria Arsimore e Filadelfias